



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2.0	Nr. Prot.	01-2178/10
Dep.		Br. Prot.	Prot No.
Nr. l faq.		Data	27.05.2010
Broj stranica	3	Datum	
pages		Date	
		PRISHTINE	



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE POLICISË SË KOSOVËS

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim

I

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Policia e Kosovës krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes:

1. Realizimit të komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit.
2. Koordinimit të punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për zbulimin dhe hetimin e korrupsionit në bazë të ligjit nr. 03/L- 159.
3. Ofrimin e këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të natyrave të ndryshme anti-korrupsion.

II

Policia e Kosovës me kërkesë të Agjencisë angazhohet që të vërë në dispozicion të Agjencisë dokumentacionin e kërkuar, që lidhen me zbulimin dhe hetimin e korrupsionit.

III

Agjencia Kundër Korrupsionit do të dërgojë dosjen e rastit në Polici në rastet kur nga natyra e veprave penale si dhe nga mënyra e kryerjes i tejkalojnë kompetencat dhe mundësitë e Agjencisë për hetimin e rasteve në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit nr. 03/L-159 dhe Ligjin për Policinë e Kosovës nr. 03 03/L-035 dhe do të jetë e gatshme për ofrimin e bashkëpunimit për hetimin e këtyre rasteve.

IV

Policia e Kosovës mund të kërkojë ndihmën e Agjencisë kundër Korrupsionit në hetimin e rasteve të dërguara nga Agjencia.

V

Agjencinë kundër Korrupsionit në rastet kur has në vështirësi në mbledhjen e informacioneve ka të drejt të kërkojë ndihmën e Policisë në pajtim me nenin 18 paragrafi 5 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr. 03-L-159.

VI

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit në luftimin e korrupsionit edhe përmes formave të tjera si:

1. Trajnimet e përbashkëta;
2. Pjesëmarrja në Seminare të përbashkëta;
3. Bashkëpunim në sferën e hetimeve penale të natyrës përkatëse.

VII

Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtarëve përkatës kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

VIII

Asnjë nga veprimet e cekura më lart, që adresojnë format e bashkëpunimit ndërinstitucional nuk guxojnë të përdoren për dëmtimin e proceseve hetimore apo formave tjera të publikimeve që mund ta diskreditojnë secilën palë nënshkruese të kësaj Marrëveshje.

IX

Kjo Marrëveshje shfuqizohet, me paralajmërim me shkrim nga njëra palë në afat prej 30 ditësh, ndërsa mospajtimet rreth shkeljes së ndonjë dispozite të kësaj marrëveshje zgjidhen përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët.

X

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe vlen për periudhën kohore prej 1 viti, me mundësi vazhdimi sipas marrëveshjes me shkrim të palëve.


XI

Marrëveshja është nënshkruar në 4 (katër) kopje identike origjinale, nga 2 (dy) kopje për secilën palë nënshkruese.

Nënshkruar në Prishtinë, me datë: 27 Maj 2010

Agjencia kundër Korrupsionit

Drejtori



Hasan Preteni



Policia e Kosovës

U.D Drejtor i Përgjithshëm

Behar Selimi

